



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2018:056792

Datë: 04.03.2024

Numri i dokumentit: 05406868

P.nr.640/2016

Gjykata Themelore në Prizren – departamenti i përgjithshëm, gjyqtari Luan Berisha, ÷në lëndën penale kundër të akuzuarve : Sh. (S.) K., R., (S.) K., dhe A. (S.) K., që të tre nga fshati Zaqishtë, Komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor, nga neni 188 par. 1 nën par. 1.4. lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Kosovës nr. 04/L-082 (KPK), sipas aktakuzës të Prokurorisë të Shtetit në Prizren, PP.nr. 2220/2015 të datës 23.03.2016, jashtë seancës gjyqësore me datë 28.02.2022,mori këtë:

A K T V E N D I M

HUDHET aktakuza e Prokurorit të Shtetit në Prizren, PP.nr. 2220/2015 të datës 23.03.2016, dhe **PUSHON** procedura penale kundër të akuzuarve Sh. K., R., K., dhe A. K., që të tre nga fshati Zaqishtë, Komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor, nga neni 188 par. 1 nën par. 1.4. lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Kosovës nr. 04/L-082 (KPK), për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale.

Të dëmtuarit M (R.) K., F (Fetah) K., dhe F (R.) K., të tre nga fshati Opterushë, komuna e Prizrenit, për reA.zimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria e Shtetit në Prizren, kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzën PP.nr. 2220/2015 të datës 23.03.2016, kundër të akuzuarve : Sh. (S.) K., R., (S.) K., dhe A. (S.) K., që të tre nga fshati Zaqishtë, Komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor, nga neni 188 par. 1 nën par. 1.4. lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Kosovës nr. 04/L-082 (KPK),

Nga shkresat e kësaj lënde rezulton se lënda është paraqitur në gjykatë dhe ate aktakuza me kërkesë për urdhër ndëshikomor me datë 23.03.2016, ndërsa vepra penale është kryer me datën 12.08.2015, ndërsa te gjyqtari gjykues kjo lëndë është pranuar me datën 30.03.2016.

Gjykata me aktgjykimin e saj P.nr.640/2016 të datës 26.08.2016, ka marrë aktgjykim në bazë të urdhërit ndëshkimor të pandehurit: Sh. K., R., K., dhe A. K., i ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor, nga neni 188 par. 1 nën par. 1.4. lidhur me nenin

31 të KPRK-së dhe për këtë veprë penale i ka gjykuar secilin me dënim me gjobë në shumën prej 300 € (treqind) euro, duke i obliguar edhe me pagesën e shpenzimeve të procedurës.

Të akuzuarit pas pranimit të aktgjykimit të lartcekur të njëjtit e kanë paguar dënimin e shqiptuar.

Me datë 11.10.2024, pranë kësaj gjykate është parashtruar kundërshtimi nga parashtruesit M (R.) K., F (Fetah) K., dhe F (R.) K., të tre nga fshati Opterushë, me propozim që kundërshtimi të aprovohet nga ana e gjykatës.

Pranë kësaj gjykate disa herë është caktuar seanca gjyqsore në të cilat seanca nuk kanë qenë prezent ndonjë nga të akuzuarit ose të dëmtuari. Gjykata sipas detyrës zyrtare ka caktuar disa seanca gjyqësore, nga të cilat disa seanca janë mbajtur, e disa seanca janë shtyer, ngase kanë munguar njëra nga palët dhe në mungesë të kushteve ligjore për mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor të njëjtën nuk e ka mbajtur.

Në rastin konkret pas shiqimit të shkresave të lëndës gjykata ka ardhur në përfundim se duke pasur parasysh që vepra penale lëndimi i lehtë trupor, nga neni 188 par. 1 nën par. 1.4. lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Kosovës nr. 04/L-082 (KPK), është e dënueshme me gjobë ose me burgim deri në 1 (një) vit, në bazë të dispozitave ligjore në kuptim të dispozitave të nenit 106 par.1 nën paragrafi 1.6 dhe nenit 107 par.8 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të paraparë të parashkrimit, gjegjësisht ndalesa absolute mbi ndjekjen penale, duke pasur parasysh që në rastin konkret kanë kaluar 4 (katër) vite nga kryerja e veprës penale.

Pra vepra penale nga ana e të akuzuarve është kryer me datën 12.08.2015, me ç ‘rast del se ka kaluar dyfishi i kohës së parashkrimit dhe atë 4 vjet, duke llogaritur prej ditës së kryerjes së veprës penale në bazë të dispozitave ligjore të lartëcekura. Parashkrimi absolut i ndjekjes penale në rastin konkret është arritur me datën 12.08.2019

Vendimi mbi kërkesën pasuror juridike është marrë në kuptim të nenit 463 par.3 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në kuptim të nenit 450 par.1 dhe 2 lidhur me nenin 454 par.1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitave të këtij aktvendimi, konform nenit 358 par.1.3 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
DEPARTAMENTI I P;RGJITHSH;M
P.nr.640/2016 me datë 28.02.2022**

**Procesmbajtësja
Naxhis Sharani**

**Gjyqtari
Luan Berisha**

UDHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur mund të ushtroj ankes në afat prej 3 ditësh nga dita e pranimit të njëjtës kolegjit penal të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.